



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 49, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“HOTEL 9 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË ME PISHINË “ROYAL 5G”, ME  
VENDNDODHJE TEK SHKËMBI I KAVAJËS, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Z. Julian Gripshi dhe shoqërisë “Deivi-2001” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Hotel 9 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë me pishinë “Royal 5G”, me vendndodhje tek Shkëmbi i Kavajës, Bashkia Durrës”, me subjekt zhvillues Z. Julian Gripshi dhe shoqërinë “Deivi – 2001” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 05, datë 30.12.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 05 datë 30.12.2021 zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 05/12/2024